



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



## Buletini III

23 Janar 2015

### Të dhëna nga monitorimi:

INPO ka vazhduar monitorimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, degët në Kaçanik dhe në Shtërpçë, në kuadër të projektit “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”. Gjatë periudhës prej 15 Dhjetor deri me 15 Janar janë monitoruar gjithsej trembëdhjet (13) seanca, prej tyre shtatë (7) seanca për vepër penale, gjashtë (6) për çështje civile. Në këto seanca është vërejtur një numër më i vogël i qytetarëve të interesuar për të marrë pjesë. Megjithatë, shumica prej tyre janë familjarë të pjesëmarrësve në gjykim, praktikant të Gjykatës, nxënës të shkollave të mesme, apo monitorues të ftuar nga organizata INPO.

### Të dhëna statistikore:

*Pjesëmarrja e qytetarëve në seanca sipas çështjes:*

Çështja e Gjykuar	Numri i pjesëmarrësve
Vepër Penale	30
Kontest Civil	20

*Pjesëmarrja e qytetarëve sipas vendit:*

Vendi	Numri i pjesëmarrësve
Gjykata Themelore Ferizaj	20
Dega Kaçanik	30

Në këto seanca si në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe në degët e saj, zyret e gjyqtarëve përdoren më shumë për gjykim se sa sallat e saj.

Edhe pse në zyret e Gjyqtarëve gjatë zhvillimit të seancës, nuk ka Polic e në anën tjetër kur ato mbahen në sallë prania e tyre është gjithmonë prezente, gjithmonë duke mos harruar që mosmarrëveshjet mes paditësit dhe të pandehurit mund të lindin edhe gjatë seancave që mbahen në zyrë.

Në seancat e monitoruara, INPO vëren se pjesmarrja e qytetarëve të interesuar që të njihen me proceset gjyqësore është shumë e vogël. Nga të gjitha këto seanca përveq studentëve dhe praktikantëve të Gjykatës dhe palëve në procedurë nuk kishte edhe shumë pjesmarrës.

Andaj, INPO përmes studentëve, që fton të marrin pjesë në monitorim, dëshiron që përmes pjesmarrjes së qytetarëve në jetën institucionale të nxitet në një formë përgjegjësi dhe transparenca e punës tek autoritetet publike. Përmes kësaj krijohet një proces më i hapur dhe më i përgjegjshëm edhe tek sjellja e vendimit.

Iniciativa për Progres, Projekti “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”

“Ky buletin u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e INPO-s dhe nuk pasqyron deomos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara”